

sagemax

Udhëzimet e përdorimit

NEXZr®

Lëng ngjyruës

Tabela e përmbajtjes

Informacioni i produktit	3
Përbërja e materialit	3
Indikacionet	3
Kundërrindikacionet/kufizimet e përdorimit	3
Shënime të përgjithshme për administrimin	3
Paralajmërime	4
Teknikat e ngjyrosjes - Përmbledhje	4
Opsioni "A" – Procesi i infiltrimit/zhytjes	4
Opsioni "B" – Teknika e lyerjes me furçë dhe procesi i infiltrimit/zhytjes	4
Koha e zhytjes	5
Tharja përfundimtare	5
Aglomerimi	6

Informacioni i produktit

Lëngjet ngjyruese të ofruara nga "Sagemax Bioceramics, Inc." ofrojnë një gamë të gjerë opsionesh të ngjyrave, si dhe rezultate të riprodhueshme e tejet estetike për restaurimet me oksid zirkoni.

Lëng ngjyrues "NexxZr® T"

- Lëngje ngjyruese për restaurime të bardha "NexxZr T" nëpërmjet infiltrimit me zhytje përpara procesit të aglomerimit
- Lëngje ngjyruese për infiltrim me zhytje në nuanca dhëmbësh 16 A–D

Lëng ngjyrues "NexxZr® Effect"

- Lëngje "Effect" për restaurime të bardha "NexxZr T" dhe restaurime të bardha "NexxZr +" me infiltrim individual ngjyre për ngjyrë të kafentë, të kaltër, të hirtë dhe vjollcë, si dhe përforcues incizioni.

Përbërja e materialit

Përbërja kimike	Lëng ngjyrues "NexxZr Effect"		Lëng ngjyrues "NexxZr T"
	I kafentë, i hirtë, vjollcë	I kaltër, përforcues incizioni	
Pigmenti i ngjyrosjes	<4%	<8%	<4%
Ujë	<96%	<92%	<96%
Acid nitrik	<1%	<1%	<1%

Indikacionet

Lëngjet ngjyruese "NexxZr" janë solucione të gatshme për ngjyrosjen e restaurimeve indirekte të paaglomeruara (këllëfë dhe ura) prej "NexxZr T" dhe "NexxZr +" me anë të teknikës së infiltrimit.

Kundërintikacionet/kufizimet e përdorimit

Çdo përdorim tjetër që nuk përmendet tek indikacionet.

Shënime të përgjithshme për administrimin

Verifikojeni mallin e dorëzuar në çastin e marrjes, për sa i përket:

- Integritetit të paketimit
- Integritetit të produktit (lëng i pastër pa turbullim apo precipitim)
- Përmendjes së "Sagemax Bioceramics" si prodhues i paketimit si dhe pranisë së shenjës CE.
- Nëse i përdorni më shumë se një herë lëngjet ngjyruese, sigurohuni të mos u ketë ndodhur kontaminim apo avullim.

Lëngjet "NexxZr" preferohet të ruhen:

- në paketimin fillestar;
- në temperatura midis 2 dhe 28°C (36 dhe 83 °F);
- të mbrojtura nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.

Kur administroni lëngjet "NexxZr", duhet të keni parasysh pikat e mëposhtme:

- Restaurimi duhet të jetë pa pluhura, mbetje nga gërryerja dhe kontaminues të tjerë
- Mos i holloni lëngjet ngjyruese.
- Lëngjet ngjyruese nuk duhet të kontaminohen.
- Lëngjet ngjyruese duhet të mbyllen hermetikisht kur nuk përdoren.
- Nëse kanë turbullimi, lëngjet ngjyruese nuk duhet të përdoren më. Kontaminimi nxit turbullimin (precipitim) ose sedimentimin e lëngjeve ngjyruese.
- Mos i dekantoni dhe/ose ruani lëngjet ngjyruese në enë metalike. Në përgjithësi, kontakti me metalin duhet parandaluar.

- Lëngjet "NexxZr Effect" vendosen mbi restaurim me një furçë të pastër, pa përmbajtje metali.
- Lëngjet duhet të tunden mirë përpara përdorimit.

Veglat e nevojshme për ngjyrosjen dhe infiltrimin janë:

- Kutia plastike për infiltrimin
- Furça
- Piskatoret plastike

Shënime të përgjithshme për restaurimet e frezuara "NexxZr"

- Restaurimi duhet të jetë pa pluhur dhe mbetje gërryerjeje.
- Restaurimet e prodhuara me forma përpunimi të njomë duhen tharë tërësisht përpara infiltrimit.
- Restaurimet e infiltruara duhet të thahen tërësisht përpara aglomerimit.
- Rekomandimi i përgjithshëm për rezultatin përfundimtar të ngjyrës: Teknika e ngjyrosjes për t'u kryer për përkimin përfundimtar të ngjyrës. Përdorni një sistem të përshtatshëm për restaurime me zirkon dhe ndiqni udhëzimet e përdorimit të prodhuesit.

Paralajmërime

- Duhet zbatuar dhe kujdesi e higjiena e zakonshme e kërkuar gjatë administrimit të kimikateve edhe kur administroni lëngjet ngjyuese.
- Evitoni kontaktin e drejtpërdrejtë me trupin (lëkurën, buzët etj.) sidomos në raste alergjish ndaj njërit prej përbërësve.
- Pas kontaktit të paqëllimshëm me lëkurën, shpëlajeni me ujë të bollshëm.
- Pas kontaktit me sytë, shpëlajeni menjëherë me ujë të bollshëm ndërsa e mbani qepallën të hapur, si dhe konsultohuni me mjekun.
- Ju rekomandojmë të mbani doreza, syze mbrojtëse dhe veshje të përshtatshme mbrojtëse.
- Lëngjet ngjyuese "NexxZr T", "NexxZr +" dhe "NexxZr Effect" mund të shkaktojnë njolla në rroba dhe sipërfaqe të tjera.

Teknikat e ngjyrosjes - Përmbledhje

Opsioni "A"

Procesi i infiltrimit/zhytjes

1. Restaurimin e frezuar dhe të pastruar zhyteni tërësisht në kutinë e mbushur me lëngun ngjyruar "NexxZr".
2. Respektoni kohën përkatëse të mbajtjes zhytur për të arritur ngjyrën e dëshiruar.
3. Shpëlajeni me ujë të distiluar për 3 sek.
4. Thajeni me kartëpecetë.
5. Sigurohuni ta thani në fund përpara aglomerimit.

Opsioni "B"

Teknika e lyerjes me furçë dhe procesi i infiltrimit/zhytjes

1. Vendosini ngjyrat "NexxZr Effect" me teknikën e lyerjes me furçë për të imituar dhëmbin natyral.
 - a. Efektet e incizionit mund të arrihen duke vendosur një herë me anë të një furçe ngjyrën e kaltër, të kafentjtë, vjollcë ose të hirtë.
 - b. Efekte të mëtejshme incizioni mund të arrihen duke vendosur përforcuesin e incizionit "NexxZr Effect".
2. Restaurimin e frezuar dhe të pastruar të zirkonit zhyteni tërësisht në kutinë e mbushur me lëngun ngjyruar "NexxZr".
3. Respektoni kohën përkatëse të mbajtjes zhytur për të arritur ngjyrën e dëshiruar.
4. Shpëlajeni me ujë të distiluar për 3 sek.
5. Thajeni me kartëpecetë.
6. Sigurohuni ta thani në fund përpara aglomerimit.

Koha e zhytjes

Ngjyra	Koha e zhytjes për "NexxZr T" në sek
A1	20
A2	20
A3	20
A3.5	20
A4	20
B1	20
B2	20
B3	20
B4	20
C1	20
C2	20
C3	20
C4	20
D2	20
D3	20
D4	20

Kini parasysih:

Në varësi të madhësisë dhe trashësisë së restaurimeve "NexxZr" me zirkon (p.sh. ura dhe superstruktura të mbajtura me implant), koha e zhytjes dhe e tharjes përfundimtare të restaurimit të infiltruar mund të luhatet.

Tharja përfundimtare

Restaurimet "NexxZr" me zirkon të infiltruara me lëng ngjyruar "NexxZr" duhet të thahen përpara aglomerimit.

Aglomerimi në gjendje të njomë duhet evituar pasi mund të shkaktojë devijim të ngjyrës dhe të ndikojë procesin e aglomerimit. Për tharje duhet përdorur llambë infrakuqe ose një kuti tharjeje. Koha e tharjes varet nga temperatura dhe madhësia e objektit/restaurimit. Temperaturat e ulëta dhe objektet e mëdha e zgjasin procesin e tharjes. Temperaturat e tharjes mbi 140°C/284°F mund të shkaktojnë defekte.

Aglomerimi

Ju lutemi të përdorni programin e mëposhtëm të aglomerimit sipas udhëzimeve të përdorimit të "NexxZr":

	Numri i njësive	Kohëzgjatja (orë)	Faza	Temperatura		Ngrohja/ftohja		Koha e qëndrimit (min)
				°C	°F	°C/min	°F/min	
Standarde	5 – 10	~5,2	Faza 1	20 – 1300	68 – 2372	30	86	60
			Faza 2	1300 – 1530	2372 – 2786	40	107	120
			Faza 3	1530 – 900	2786 – 1652	15	59	–
			Faza 4	900 – 80	1652 – 176	20	68	–
E zgjatur	1 – 20	~10,8	Faza 1	20 – 900	68 – 1652	10	50	10
			Faza 2	900 – 1530	1652 – 2786	3	37	150
			Faza 3	1530 – 80	2786 – 176	8	46	–
	>21	~12,8	Faza 1	20 – 900	68 – 1652	10	50	10
			Faza 2	900 – 1530	1652 – 2786	3	37	210
			Faza 3	1530 – 80	2786 – 176	8	46	–
Gjatë natës	E pakufizuar	~14,3	Faza 1	20 – 250	68 – 482	2	35	–
			Faza 2	250 – 1530	482 – 2786	4	39	240
			Faza 3	1530 – 80	2786 – 176	8	46	–

sagemax



Prodhuar nga:

Sagemax Bioceramics, Inc.

34210 9th Avenue S, Ste. 118

Federal Way, WA 98003 USA

Tel. : +1 253-214-0389

support@sagemax.com

www.sagemax.com

E	C	R	E	P
---	---	---	---	---

Përfaqësuesi për KE-në:

AB Ardent

Generatorgatan 8

SE-19560 Arlandastad Sweden

Tel.: +46 8594 412 57

eu1@sagemax.com

www.sagemax.com

CE 0123

RX only

Data.: 2018-10-30/Rev.0

SQ